

INNOVATION CHALLENGE FUND THIRRJA E TRETË PËR APLIKIME

Çfarë është INOVACIONI në kontekstin e Challenge Fund?



- Një zgjidhje e cila i shton vlerë biznesit tuaj
- E bën atë më eficient
- Zvogëlon kostot dhe kohën
- Mund të jetë një zgjidhje e re e cila ka të bëjë me një proces, një produkt ose shërbim
- I jep zgjidhje një sfide që hasni në përditshmëri në biznesin tuaj
- Një zgjidhje e cila funksionon mirë në kontekstin lokal ku operon biznesi juaj

Çfarë kërkojmë nga ju?

- Një propozim biznesi NOVATIV
- Një propozim biznesi të REALIZUESHËM dhe të QËNDRUESHËM
- Një propozim biznesi i cili ka IMPAKT SOCIAL



Kush mund të aplikojë në Challenge Fund?



- LOT 1: FAZA E IDESE DHE VALIDIMIT- një themelues ose një ekip në fazat e hershme të zhvillimit të një ideje biznesi inovatore (jo entitet i regjistruar në QKB).
- LOT 2: FAZA E RITJES- një subjekt biznesi me status aktiv i regjistruar brenda 12 muajve nga data e regjistrimit zyrtar të subjektit në QKB deri në datën e publikimit të Thirrjes për Propozime.
- LOT 3: FAZA E ZHVILLIMIT- një subjekt biznesi me status aktiv i regjistruar brenda 13 muajve dhe 6 viteve nga data e regjistrimit zyrtar të subjektit në QKB deri në datën e publikimit të Thirrjes për Propozime.

Për sa fonde mund të aplikoni?

- Lot 1: Faza e idesë dhe validimit, deri në 10,000 Euro
- Lot 2: Faza e rritjes, deri në 20,000 EUR
- Lot 3: Faza e zhvillimit, deri në 30,000 EUR



Sa është përqindja e bashkë-financimit?



- Lot 1: Faza e idesë, 5% bashkëfinancim
- Lot 2: Faza e rritjes, 20% bashkëfinancim
- Lot 3: Faza e zhvillimit, 30% bashkëfinancim

Cilët janë sektorët me prioritet?

- Turizimi dhe industritë e lidhura me të;
- Bujqësia dhe industritë e lidhura me të;
- Ekonomia e gjelbër, duke përfshirë inovacionin klimaterik dhe energjinë;
- TIK, si teknologji mundësuese për sektorë të ndryshëm.



Cilat janë kriteret e aplikimit?

- Aplikanti duhet të jetë person juridik (entitet biznesi) i regjistruar dhe që operon në Shqipëri për LOT 2 dhe LOT 3;
- Aplikanti duhet të sigurojë që start-up të regjistrohet dhe të operojë në Shqipëri në momentin që shpallet fitues dhe përpara lidhjes së kontratës, vetëm për LOT 1;
- Aplikantët nga diaspora Shqiptare dhe aplikantët jo Shqiptarë kanë të drejtë të aplikojnë me kusht që biznesi i tyre të zhvillohet në Shqipëri. Referojuni Udhëzuesit për Aplikantët për kriteret e pranueshmërisë në lidhje me aplikantët jo Shqiptarë;
- Duhet të mos jetë regjistruar në QKB për më shumë se 6 vjet nga data e publikimit të Thirrjes për Propozime;
- Statusi operativ i biznesit është AKTIV në momentin e aplikimit për këtë Thirrje për Propozime;
- Aplikanti duhet të sigurojë pjesën e bashkëfinancimit të vlerës totale të buxhetit të propozuar, në përqindjen përkatëse, siç parashikohet në seksionin 4.2. të Udhëzuesit për Aplikantët;
- Aplikanti nuk ka detyrime për pagesën e taksave ndaj autoriteteve kombëtare dhe vendore (zbatohet vetëm për Lotin 2 dhe 3);
- Aplikanti nuk ndiqet penalisht nga Prokuroria;
- Aplikanti nuk është në proces penal nga Gjykata;
- Aplikanti nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për një çështje penale nga Gjykata.
- Aplikanti ka përgjegjësi të plotë për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të përfshira në aplikim.
- Periudha për zbatimin e fondit do të jetë 6 - 8 muaj.



Çfarë ofrojmë ne?

- Jo vetëm fonde.
- Program trajnimi për ngritjen e kapaciteteve në fushën e të bërit biznes dhe për të siguruar qëndrueshmëri të biznesit.
- Program trajnimi për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me menaxhimin e grantit.
- Mentorim, sipas nevojave specifike të biznesit tuaj, përgjatë periudhës së zbatimit të grantit.
- Seminare për të ofruar mundësi për start-up-et e Fazës së I-rë dhe Fazës së II-të të EU4Innovation për të shkëmbyer përvoja, praktikat e mira dhe për të ndërtuar partneritete të ardhshme biznesi.
- Ekspozim dhe promovim të gjerë në tregun vendas dhe ndërkombëtar.



Si të aplikosh?

Apliko online: <https://apply.challengefund.euforinnovation.al/>

I gjithë procesi i aplikimit, vlerësimit, dhe përgjigjia e pyetjeve tuaja do të bëhen online, duke siguruar një proces të thjeshtë dhe transparent.

Jepi kohën e nevojshme aplikimit!

Merrni parasysh kohën e nevojshme që ju duhet për përgatitje para se të dorëzoni aplikimin. Informacioni që do t'ju kërkohet gjatë aplikimit, do të kërkojë një analizë të qenësishme të biznesit tuaj, ndaj ju sugjerojmë të shikoni me kujdes Udhëzuesin për Aplikantët (Guidelines Document) si dhe formularët e aplikimit offline, përpara se të plotësoni aplikimin online.

Gjatë plotësimit të formularit online, keni mundësinë ta ruani atë dhe të vazhdoni punën më pas.

Kur ju shtypni butonin SUBMIT, aplikimi juaj konsiderohet i përfunduar dhe NUK mund të modifikohet.



Si do të realizohet vlerësimi i aplikimeve?

Vlerësimi do të realizohet në 3 faza:

- 1) Kontrolli administrativ;
- 2) Vlerësimi Teknik për aplikantët që kanë kaluar kontrollin administrativ, i cili do të pasohet edhe nga vizita në terren;
- 3) Konkursi i hapur ku bizneset e përzgjedhura nga faza e dytë do të prezantojnë idetë e biznesit para një paneli ekspertësh.



DATA TË RËNDËSISHME

7 shkurt - 17 mars 2025
APLIKIMET JANË TË HAPURA

Mars - Qershor 2025
VLERËSIMI I PROPOZIMEVE

Keni pyetje?

Na shkruani në:

challengefund@euforinnovation.al

Keni nevojë për asistencë gjatë aplikimit?

Lexoni me kujdes Udhëzuesin për Aplikantët (Guidelines Document) i publikuar në faqen <https://challengefund.euforinnovation.al>

Merrni pjesë në Sesionet Informuese që do të zhvillohen në kuadër të Thirrjes së Tretë, sipas kalendarit të përcaktuar në Udhëzuesin për Aplikantët (Guidelines Document).

Apliko tani